



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 73, datë 22.04.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Vendimin Nr.64, datë 15.04.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”” i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zoti Kledian Llaho**, prokuror i transferuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
2. Zoti Kledian Llaho do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, nga data 24.04.2022 - 23.07.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Kledian Llaho do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kledian Llaho, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 22.04.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
SOKOL STOJANI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
ZEQIR HODA

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR  
MIRELA BOGDANI